



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË - DEGA E GJYKATËS FUSHË KOSOVË

Numri i lëndës: 2021:083315

Datë: 22.01.2024

Numri i dokumentit: 05218336

C.nr. 1976/21

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË – DEGA NË FUSHË KOSOVË, Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtaren Qëndresa Beqiri Murati, në çështjen juridike kontestimore të paditëseve S. B, - Rr., V. K dhe Sh. B, të cilat sipas autorizimit i përfaqësojnë B. U dhe L. H, të dy avokat në Prishtinë, kundër të paditurës Komuna e Fushë Kosovës – Drejtoria Komunale për Arsim me seli në Fushë Kosovë, me objekt kontesti kompensimin e shujtave ditore dhe shpenzimeve të udhëtimit në punë, jashtë seancës, me datë 22.01.2024 mori këtë:

AKTGJYKIM

I.APROVOHET SI E BAZUAR kërkesëpadia e paditëseve S. B. - Rr, V. K dhe Sh. B, ashtu që DETYROHET e paditura Komuna e Fushë Kosovës – Drejtoria Komunale e Arsimit, që për periudhën kohore nga data 14.09.2020 e deri më 03.03.2021 paditëseve t’ua kompensoj shumat si në vijim:

- paditëses S. B. - Rr, në emër të kompensimit për ushqim për ditët e pranisë në punë për 110 ditë pune, t’ia paguaj shumën prej 220.00 euro, dhe në emër të shpenzimeve të udhëtimit në relacion Prishtinë –dhe anasjelltas në lartësi prej 70% të biletës së autobusit për periudhën e njëjtë, t’ia paguaj shumën prej 77.00 euro;
- paditëses V. K në emër të kompensimit për ushqim për ditët e pranisë në punë, për 110 ditë pune, t’ia paguaj shumën prej 220.00 euro dhe në emër të shpenzimeve të udhëtimit në relacion dhe anasjelltas, në lartësi prej 70% të biletës së autobusit për periudhën e njëjtë, t’ia paguaj shumën prej 46.20 euro;
- paditëses Sh. B në emër të kompensimit për ushqim për ditët e pranisë në punë, për 110 ditë pune, t’ia paguaj shumën prej 220.00 euro dhe në emër të shpenzimeve të udhëtimit në relacion dhe anasjelltas në lartësi prej 70% të biletës së autobusit për periudhën e njëjtë, t’ia paguaj shumën prej 46.20 euro;

Të gjitha këto me kamatë ligjore prej 8% në vit, e cila do të llogaritet nga data e paraqitjes së padisë në gjykatë (datë 29.04.2021) e deri në pagesën definitive, të gjitha në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të detyrueshëm;

III. DETYROHET e paditura Komuna e Fushë Kosovës – Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditëseve t’ua paguaj shpenzimet e procedurës në shumë prej 228.00 euro, në afat prej 7 ditësh nga marrja e aktgjykimit.

A r s y e t i m

Paditëset S. B. – Rr., V. K dhe Sh. B, përmes të autorizuarve të tyre, pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë me datë 29.04.2023 kanë parashtruar padi kundër të paditurës Komuna e Fushë Kosovës – Drejtoria Komunale e Arsimit, me seli në Fushë Kosovë, për kompensimin e shujtave ditore dhe shpenzimeve të transportit. Paditëset në padi, ndër të tjera, kanë theksuar se janë në marrëdhënie të rregullt pune tek e paditura dhe atë në pozitën e mësimdhënësive në SH.F.M.U “B...” në. Tutje kanë theksuar se e paditura nuk iu ka paguar kompensimin për ushqim gjatë punës, për periudhën e kërkuar, dhe as shpenzimeve të transportit ashtu siç përcaktohet në Kontratën Kolektive të Arsimit në Kosovë. Nga gjykata kanë kërkuar që të aprovet në tërësi padia e paditëseve si e bazuar. Shpenzimet e procedurës i kanë kërkuar dhe atë shumën prej 208.00 euro në emër të përpilimit të padisë në bazë të tarifës së Odës së Avokatëve të Kosovës.

Gjykata në këtë çështje juridike kontestimore, pas shqyrtimit paraprak të padisë ka nxjerrë aktvendimin për përgjigje në padi më datën 06.11.2023, të cilin aktvendim e paditura bashkë me padinë dhe të gjitha shkresat e lëndës e ka pranuar me datën 14.11.2023 (e cila është konfirmuar përmes fletëkthesës, e cila gjendet në shkresat e lëndës).

Me aktvendimin për përgjigje në padi, gjykata e ka njoftuar të paditurën për detyrimin ligjor për dhënie të përgjegjës në padi dhe për pasojat ligjore që do t’i ketë nëse nuk paraqet përgjigje në padi, gjegjësisht për mundësinë që gjykata të marrë aktgjykim për shkak të mosbindjes.

E paditura, pavarësisht se e ka pranuar aktvendimin për përgjigje në padi, së bashku me padinë dhe provat materiale në këtë çështje juridike kontestimore, nuk ka paraqitur përgjigje në padi brenda afatit ligjor, gjegjësisht deri në datën e nxjerrjes së këtij aktgjykimi.

Gjykata, pasi i ka vlerësuar kushtet ligjore për nxjerrjen e aktgjykimit për shkak të mosbindjes, ke gjetur së në rastin konkret plotësohen të gjitha kushtet ligjore për nxjerrjen e aktgjykimit në fjalë nga neni 150 paragrafi 1 pikat a), b) dhe (c) të LPK-së, i cili ka përcaktuar se nëse të paditurit i është dorëzuar padia dhe thirrja për përgjigje në padi, se themelësia e kërkesëpadiës del nga faktet e treguara në padi dhe se faktet në të cilat mbështetet kërkesëpadia nuk janë në kundërshtim me provat që i ka propozuar vetë paditësi apo me faktet e ditura botërisht.

Gjykata nga provat që i janë bashkangjitur padisë e ka vërtetuar faktin se paditësit janë në marrëdhënie pune te e paditura. Nga kontrata e punës me numër protokollit 335, e datës 01.09.2015, gjykata gjeti se paditësja S. B. – Rr. është e punësuar në SH.F.M.U “B...”, në pozitën mësimdhënëse e muzikës. Ndërsa përmes vërtetimit të lëshuar po nga kjo shkollë, i datës 03.03.2021, gjykata gjeti se paditësja për vitin shkollor 2020/2021 ka gjithsej 110 ditë të prezencës në punë. Nga vërtetimi me numër protokollit 795, i datës 03.03.2021, vërtetohet se paditësja në fjalë ka adresë të përhershme në Prishtinë, , ndërsa nga vërtetimi i lëshuar nga Operatori Transportues “A...” i datës 05.03.2021 vërtetohet se lartësia e biletës njëdrejtimëshe në destinacionin Prishtinë – është 0.50 euro.

Nga kontrata e punës me numër protokollit 348/16, e datës 01.09.2016, gjykata gjeti se paditësja V. K është e punësuar në SH.F.M.U “B...” në, në pozitën mësimdhënëse e kimisë. Ndërsa përmes vërtetimit me numër 47/2021, të datës 03.03.2021, gjykata gjeti se paditësja nga data 14.09.2020 deri me datë 03.03.2021, ka gjithsej 110 ditë të prezencës në punë. Nga certifikata e vendbanimit B..., e datës 02.03.2021 e njëjta ka vendbanim në, komuna Fushë Kosovë, ndërsa nga vërtetimi i lëshuar nga Operatori Transportues “A...” i datës 05.03.2021 vërtetohet se lartësia e biletës njëdrejtimëshe në destinacionin Fushë Kosovë – është 0.30 euro.

Nga kontrata e punës me numër protokollit 354, e datës 01.09.2015, gjykata gjeti se paditësja Sh. B është e punësuar në SH.F.M.U “B...” në, në pozitën mësimdhënëse e artit figurativ. Ndërsa përmes vërtetimit të lëshuar nga kjo shkollë, i datës 03.03.2021, gjykata gjeti se paditësja nga data 14.09.2020 deri me datë 03.03.2021 ka gjithsej 110 ditë të prezencës në punë, nga certifikata e vendbanimit B..., e datës 03.03.2021 e njëjta ka vendbanim në komuna Fushë Kosovë, ndërsa nga vërtetimi i lëshuar nga Operatori Transportues “A...” i datës 05.03.2021 vërtetohet se lartësia e biletës njëdrejtimëshe në destinacionin Fushë Kosovë – është 0.30 euro.

Neni 329 par. 1 i LPK-së ka përcaktuar se “*Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të*”. Së këndejmi, provave që kishin të bënin me vërtetimin e ekzistimit të marrëdhënies së punë, si dhe fakteve lidhur me ditët e prezencës në punë, gjykata ua falë besimin e plotë, ngase është bërë e besueshme fuqia provuese e tyre.

Lidhur me bazën juridike të kërkesëpadisë, Gjykata vlerëson se në rastin konkret duhet të aplikohen dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë (KKAK), të nënshkruar në mes të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, e cilat ka hyrë në fuqi me datë 18.04.2017 dhe Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë, e cila ka hyrë në fuqi me datë 22.01.2021, për faktin se kërkesëpadia e paditësve për kompensimin e ushqimit gjatë punës ka të bëjë me periudhën kohore nga data 14.09.2020 e deri me datë 03.03.2021, periudhë kjo gjatë së cilës Kontratat e lartcekura kanë qenë në fuqi.

Në padi, paditësit kanë theksuar se nuk kanë pranuar kompensimin në emër të ushqimit për ditët e kaluara në punë për periudhën kohore nga data 14.09.2020 e deri me datë 03.03.2021. Nga vërtetimet si më lart, gjykata gjen se të tri paditëset kanë qenë 110 ditë prezentë në punë, prandaj gjykata ditët e kaluara në punë të paditësve i ka shumëzuar me nga 2 euro, rrjedhimisht duke i njohur shumën si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Këtë lloj kompensimi gjykata ia njohu paditësve në harmoni me nenin 35 paragrafi 7, të KKAK-së i cili ka përcaktuar se “*Të punësuarve, u sigurohet kompensim për ushqime gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimeve të ushqimit në punë, për një ditë pune, është 2(dy) euro për të punësuarit të cilët kanë marrëdhënie pune primare në institucionet arsimore. Punëdhënësi, i cili ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve, përmes restorantit kuzhinës, ose në një formë tjetër, nuk ka obligim pagese, të të punësuarve për ushqim*”. Ndërsa njëjtë është përcaktuar edhe në

dispozitën e nenit 35 paragrafi 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovës të datës 22.01.2021.

Sa i përket pjesës së kërkesëpadisë së paditëses V. K për shpenzimet e udhëtimit gjykata në bazë të certifikatës së vendbanimit B..., datës 02.03.2021 vërtetohet se paditësja V. K e ka adresë të përhershme në , komuna Fushë Kosovës, ndërsa nga vërtetimi - çmimorja e lëshuar nga Operatori transportues "A..." gjeti se paditësja për periudhën e si në precizim të kërkesëpadisë për 110 ditë pune ka paguar biletë (vajtje - ardhje 0.60 euro x 70% =0.42 euro x 110 ditë = 46.20 euro). Sa i përket paditëses S. B - Rr, gjykata në bazë të vërtetimit me numër protokollit 795, i datës 03.03.2021, vërtetohet se paditësja në fjalë ka adresë të përhershme në Prishtinë, rruga "Vushtrria" numër 10, ndërsa nga vërtetimi - çmimorja e lëshuar nga Operatori transportues "A.", gjykata gjeti se paditësja për periudhën e si në precizim të kërkesëpadisë për 110 ditë pune ka paguar biletë (vajtje - ardhje 1.00 euro x 70% =0.70 euro x 110 ditë = 77.00 euro). Në lidhje me paditësen Sh. B, sa i përket shpenzimeve të udhëtimit, gjykata në bazë të certifikatës së vendbanimit B..., e datës 03.03.2021, vërtetohet se paditësja Sh. B ka adresë të banimit në, komuna Fushë Kosovës, ndërsa nga vërtetimi - çmimorja e lëshuar nga Operatori transportues "A..." gjeti se paditësja për periudhën e si në precizim të kërkesëpadisë për 110 ditë pune ka paguar biletë (vajtje - ardhje 0.60 euro x 70% =0.42 euro x 110 ditë = 46.20 euro), krejt kjo në harmoni me nenin 35 par.5, të KKAK-së i cili ka përcaktuar se *"Punonjësit arsimorë që udhëtojnë në vendbanimet e komunës përkatëse ku punojnë i paguhen shpenzimet e rrugës 70%*

Lidhur me lartësinë e kamatës së llogaritur prej 8%, gjykata vendosi në kuptim të nenit 382 të LMD-së, sipas të cilit *"Debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debiton, përpos borxhit kryesor, edhe kamatën"*. Ndërsa paragrafi 2 i këtij neni ka përcaktuar se *"Lartësia e kamatëvonesës është tetë për qind (8%) në vit, përveç nëse parashihet ndryshe me ligj të veçantë"*, e llogaritur nga dita e parashtrimit të padisë datë 23.04.2021.

Vendimin që pala e paditur t'i bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitën nga neni 452 të LPK - së. Lartësia e shpenzimeve të procedurës të aprovuara në shumë prej 228.00 euro i referohet shpenzimeve për përpilimin e padisë, në shumë prej 208.00 euro dhe për taksë gjyqësore për padi në shumë prej 20.00 euro.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË – DEGA NË FUSHË KOSOVË

Departamenti i Përgjithshëm
C.nr.1976/21, datë 22.01.2024

Gjyqtarja
Qëndresa Beqiri Murati

KËSHILLË JURIDIKE: *Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditësh, nga dita e marrjes së te njëjtit, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.*